Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 822/20
Datë/Datum. 27.10.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Kreshnik Spahiu;	22.10.2020	27.10.2020	822/20
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 19.10.2020, OE "Botek" SH.P.K-Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër 822/20, kundër dokumenteve të tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Konsolidimi i infrastrukturës se IT-se dhe Storage për Backup" me nr. të prokurimit: 318-20-5711-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 30,000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim in Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:

- Neni 1, Qëllimi;
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7, Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi;
- Neni 27, Dosja e Tenderit;
- Neni 28, Specifikimet teknike.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Ne qëndrojmë ne pretendimet tona te cilat i kemi parashtruar ne Kërkesën për Rishqyrtim te datës 07.10.2020,

te cilën ia bashkëngjisim kësaj ankese.
Me poshtë elaborojme edhe një here dispozitat ligjore te shkelura nga Autoriteti Kontraktues-KPMM.

1. Sipas nenit 1, Qëllimi i ligjit te prokurimit publik është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe mete drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove duke përcaktuar kushtet dhe rregullat qe do te zbatohen, procedurat qe do te ndiqen, te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet qe do te përmbushen nga personat, operatoret ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesioneret e punëve dhe organet publike qe zhvillojnë, përfshihen, marrin pjese ose interesohen, ne aktivitetet e prokurimit ose qe përfshihen ose kane te bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Autoriteti Kontraktues përmes përgatitjes se specifikimeve teknike te cilat i janë përshtatur vetëm një prodhuesi te caktuar dhe për te cilat pajisje ne Kosove ka mundësi vetëm një operator ekonomik i caktuar te i sjelle sepse prodhuesi i pajisjeve nuk lëshon autorizime tjera, atëherë kjo me automatizëm ndikon ne mënyrë te drejtpërdrejtë ne shfrytëzim jo efikas dhe transparent te fondeve publike. Ne raste te tilla kemi mungese te konkurrencës, transparencës dhe shfrytëzim te drejte te fondeve publike. Pasi qe AK-KPMM ju ka përshtatur specifikimet teknike vetëm një prodhuesi atëherë nuk ka pasur nevoje te shpall tender përmes procedurës se hapur, por ka qene dashur te shkoj përmes procedurës se negociuar, sepse ne fund te fundit cila do procedure qe përdoret me këto specifikime teknike do te kemi vetëm një operator ekonomik te përgjegjshëm.

2. Sipas nenit 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, te gjitha autoritetet kontraktuese, janë te obliguara qe te sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te përdoren ne mënyrën me ekonomike, njëkohësisht duke marre ne konsiderate qëllimin dhe lenden e prokurimit. Ne këtë rast AK-KP MM nuk ka marre për baze mënyrën e shfrytëzimi te fondeve publike ne formën me ekonomike sepse ka eliminuar përmes përshtatjes se specifikimeve teknike prodhues te mëdhenj botëror, te cilët prodhojnë pajisje te tilla te cilat janë kërkuar nga AK-KPMM. Eliminimi i tille dhe pamundësia për te ofertuar neve si OE te cilët jemi te autorizuar nga disa prodhues te mëdhenj botëror do te ndikon ne shfrytëzim jo ekonomik te fondeve publike, sepse ofertuesi i caktuar duke ditur qe nuk ka konkurrence te caktuar do te përgatis ofertën me çmim maksimal te mundshëm.

3. Neni 7, Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi, Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabarte dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne mënyrë transparente. Ne këtë rast AK-KPMM ka përdorur specikfime teknike duke i diskriminuar te gjithë prodhuesit tjerë ne përjashtim te një prodhuesi, kjo ne mënyrë te drejtpërdrejt na ka diskriminuar neve si operator ekomomik te interesuar dhe prodhuesit potencial mete cilët ne bashkëpunojmë.

4. Neni 27, Dosja e Tenderit, AK-KPMM ka përgatitur ne përgjithësi dosje te tenderit dhe ne ve9anti pjesën e specifikimeve teknike ne kundërshtim me nenet e lartcekura dhe dispozitat tjera ligjore te LPP-se dhe kërkojmë nga AK-KPMM qe te beje ndryshime te dosjes se tenderit ne harmoni me dispozitat ligjore te LPP-se.

5. Neni 28, Specifikimet teknike, sipas paragrafit 2 te nenit 28 te LPP-se " *Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike ne atë mënyrë qe ato te jene ne përputhje me qëllimin e prokurimit dhe te drejtuara drejt sigurimit te qasjes sa me te mire për te gjithë operatoret e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar qe te hartoje specifikime teknike qe favorizojnë* ose *diskriminojnë një* ose *me shume operatore ekonomik*".

Po ashtu paragrafi 7 i nenit 28 te LPP-se thotë "Autoriteti kontraktues nuk do te përpilojë specifikimet teknike qe i referohen një artikulli ose burimi te veçante, ose një procesi te hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine te veçante ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, qe ne kushte te jashtëzakonshme, te hartoje specifikime teknike ose te beje një referim te tille te veçante, nëse autoriteti kontraktues ne mënyrë te qarte vërteton se, nuk është e mundur qe te përpilojë një specifikim mjaft te sakte dhe te kuptueshëm te lendes se kontratës përkatëse, ne pajtim me paragrafin 3-6. te këtij neni ose ndryshe; me kusht qe, 9faredo referimi i tille te shoqërohet me fjalët "ose eku1valent"

Ne rastin konkret AK-KPMM saktësisht personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike nuk kane zbatuar ne asnjë rast paragrafin 7 te nenit 28 sepse edhe pse ju kane referuar prodhuesit te caktuar nuk kane përdorur ne asnjë rast fjalën " ose ekuivalent". Ne Kërkesën për Rishqyrtim te dorëzuar me date 07.10.2020, kemi cekur te gjitha këto shkelje ku i kemi bere me dije edhe AK-KPMM se specifikimet teknike janë diskriminues dhe i kemi njoftuar sakte se cilit prodhues i janë përshtatur këto specifikime, si dhe cilët prodhues botëror janë eliminuar nga konkurrenca.

Me date 08.10.2020 kemi marre Vendimin e AK-KP MM si përgjigje ne Kërkesën tone për Rishqyrtim, ku Autoriteti Kontraktues e cilëson Kërkesën tone si te pabazuar dhe refuzohet pa ndonjë baze ligjore.

Vien te theksohet fakti se ne përgjigjet e AK-KPMM-se rreth pjesës se specifikimeve teknike ne asnjë rast nuk e arsyetojnë me ndonjë fakt mirëpo vetëm përgjigja e tyre është, citat "

> KPMM pa dashur te diskriminoj asnjë prodhues te caktuar për pajisje te tille ka përgatitur këto specifikime teknike ne harmoni me nevojat dhe kërkesat e KPMM-se duke marrë për baze gjendjen ekzistuese te infrastrukturës se IT-se qe kemi brenda ne KPMM.
>
> Specifikat teknike janë te përgatitura sipas nevojave te KPMM për Upgrade te infrastrukturës ekzistuese. OE duhet te ofrojnë zgjidhe qe plotësojnë te gjitha kërkesat minimale te detyrueshme sipas dosjes se tenderit.

Ne si operator ekonomik nuk e kuptojmë qëllimin dhe tendencën e AK-KPMM për te mos ofruar informata te mjaftueshme te gjendjes ekzistuese te cilën e kane brenda sistemit te tyre dhe kjo tregon se ata nuk janë transparent ne këtë aktivitet te prokurimit.

Ne këto raste kur pajisjet e reja ndërlidhen me një gjendje ekzistuese te ndonjë sistemi ekzistues brenda autoritetit kontraktues, fillimisht autoritet kontraktues duhet ta përshkruaj atë gjendje ne atë mënyre qe te gjithë operatoret ekonomik te jene te njoftuar për këtë.

Nga kjo lind pyetja për AK-KPMM si mund ta dine operatoret ekonomik gjendjen ekzistuese brenda AK-KPMM nëse ju nuk e keni përshkruar ne dosje te tenderit.

Bazuar ne shkeljet e lartcekura te dispozitave ligjore te LPP-se kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-se te detyron AK-KPMM konform kompetencave te veta ligjore te beje korrigjim te njoftimit për kontrate dhe ndryshim te specifikimeve teknike te dosjes se tenderit për ketë aktivitet te prokurimit

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "BOTEK" SH.P.K - PRISHTINË

Përgjigje në Pretendimin ankimor : Pretendimi ankimor i OE ankues ka të bëjë me favorizimin e prodhuesve të caktuar duke përshtatur specifikimet teknike të vendosura nga AK në dosjen e tenderit, mungesën e transparencës për pajisjet aktuale dhe vendimit të pabazuar për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

AK në dosjen e tenderit, Ankesi 1–Specifikimet teknike të detyrueshme ka paraqitur specifikimet teknike për

për 3 pozicionet e pajisjeve që janë kërkuar. OE ankues me datë 07.10.2020 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimet se janë përshtatur specifikat teknike për të tri pozicionet. Konkretisht për Storage dhe Server janë përshtatur për prodhuesin IBM/Lenovo dhe për switch janë përshtatur për pajisjet e prodhuesit CISCO, dhe në të njëjtën kohë janë përjashtuar prodhuesit e tjerë.

AK me datës 08.10.2020 nxjerr vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Në arsyetimin e vendimit, AK nuk i mohon pretendimet për specifikim diskriminuese, dhe thirret në nevojën e AK-së për këto specifikime të pajisjeve për shkak të upgrade-it (ngritjes) së infrastrukturës ekzistuse.

Eksperti teknike në dosjen e tenderit ka vërejtur se specifikimet teknike sikurse janë listuar edhe nga OE ankuesja janë shumë të detajuara në disa pozicione dhe i përshtaten pajisjeve të prodhuesve të caktuar dhe si të tilla janë diskriminuese.

Po ashtu, në këto specifikime janë kërkuar opsione dhe protokolle të panevojshme, ku AK nuk ka arsyetuar nevojën për vendosjen e kërkesave të tilla.

Më tej AK në dosje të tenderit këtë aktivitet e ka prezantuar si projekt të ri dhe këto pajisje si tërësi e një sistemit të ri, i cili si i tillë duhet të integrohet me pajisje aktuale. Pra, siç është specifikuar në dosjen e tenderit, projekti ka të bëjë me zgjerim të infrastrukturës dhe jo me upgrade të pajisjeve ekzistuese.

Në këtë rast kur kume të bëjmë me pajisje të reja që duhet të komunikojnë apo ndërlidhen me pajisjet ekzistuese, AK është dashur që të ofrojë informacione të detajuara për pajisjet ekzistuese dhe në kërkesa të specifikoj që pajisjet e reja duhet të funksionojnë dhe të bashkëveprojnë në kapacitete të plota.

Në fund, marrë për bazë Nenin 28 të LPP-së ku thuhet që specifikimet teknike duhet të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës, rekomandohet që AK të ndërmerr masa për korrigjimin e specifikimeve teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë OE.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Më tej propozohet që të obligohet AK të bëj korrigjimet e specifikimeve teknike dhe të bëhet zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave konform dispozitave të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – "Botek" SH.P.K - Prishtinë